Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna Istog
Opština Istok
Istog Municipality

001 Numër:160/2026
Data:19.11.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve te Kuvendit te Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e **11-të** të rregullt të Legjislatura të VIII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet me**: 27.11.2026, e Premte,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00.**

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit Komunal për Transport 2026 – 2030.
5. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba.
6. Shpallje në Diskutim Publik i Planit të Punës për Ekipin e Komunës për të Drejtat e Fëmijëve- Istog 2027-2030
7. Shpallje në Diskutim Publik të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2027-2030
8. Shpallje në Diskutim Publik e Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2027 – 2030
9. Shpallje në Diskutim Publik e Planit të Integritetit për Komunën e Istogut 2027 - 2030
10. Shpallje në Diskutim Publik e Strategjisë për Komunikim dhe Informim 2027 – 2030,
11. Shpallje në Diskutim Publik e Planit Tre Vjeçar për Banim Social i Komunës së Istogut 2027-2030.
12. Shpallje në Diskutim Publik e Planit Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimit të huajve në Istog 2027 - 2030
13. Shpallje në Diskutim Publik e Planit Zhvillimor i arsimit i Komunës së Istogut 2027– 2030
14. Shpallje në Diskutim Publik e Planit Komunal për Reagim Emergjent,
15. Shpallje në Diskutim Publik e Planit Lokal për Veprim në Mjedis,

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Vërejtje :
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVI

001Nr. /2026
Datë: .2026

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL NË ISTOG PËR VITIN 2027

Synimi

Me këtë Plan synohet që Kuvendi i Komunë të jetë sa më funksional në realizimin e kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin dhe aktet tjera nënligjore.

Objektivat

Kuvendi Komunal në Istog si organ përfaqësues dhe vendim-marrës i Komunës para së gjithash ka për objektiv ndërtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes Kuvendit dhe Ekzekutivit, qytetarëve dhe grupeve të interesit, organeve të pushtetit qendror dhe atë nder komunale, funksionimin sa më normal dhe efikas të Kuvendit sipas mandatit dhe përgjegjësive që ka, zhvillimin e demokracisë së brendshme, transparencës dhe kontrollit e mbi të gjitha respektimin dhe zbatimin e Kushtetutës dhe të gjitha ligjeve si derivat i saj si dhe miratimin dhe harmonizimin e të gjitha akteve normative Komunale me ligjet në fuqi me interes të përgjithshëm.

Qëllimi

Ky plan ka për qëllim informimin e drejtë dhe me kohë të te gjitha institucioneve komunale, organeve qendrore, qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe çdo grupi të interesit lidhur me punën dhe aktivitetet e Kuvendit Komunal, komiteteve dhe trupave tjerë ndihmës të Kuvendit që mundëson realizimin e të drejtës të te gjitha grupeve të interesit të jenë akter serioz në vendimmarrje dhe të kenë ndikim në ngritjen transparencës, përgjegjësisë, cilësisë dhe efikasitetit në punë të te gjitha organeve të Komunës.

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Janar	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2026. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026. 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2026. 4. Shqyrtimi i raportit të punë së KKSB-së për vitit 2026. 5. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2026, 6. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve-Istog 2024-2026, 7. Shqyrtimi i Raportit të	27.01. 2027	1. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2026. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026. 3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2026. 4. Shqyrtimi i raportit të punë së KKSB-së për vitit 2026. 5. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2026, 6. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve-Istog 2024-2026, 7. Shqyrtimi i Raportit të	19.01. 2027	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 2. Shqyrtimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete gjatë viti 2026 3. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katër, tetor-dhjetor 2026.	25.01. 2027

	Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026, 8. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2026, 9. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë, 10. Raporti vjetor i mekanizimit komunal kundër Dhunës në Familje për vitin 2026, 11. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi		Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026, 8. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2026, 9. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë, 10. Raporti vjetor i mekanizimit komunal kundër Dhunës në Familje për vitin 2026, 11. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi			

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Shkurt	Mbledhje Solemne e Kuvendit Komunal me rastin e 17 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. **1.** Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. ”Ambienti” për vitin 2026. **2**. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	17.02. 2027 25.02. 2027	**1.** Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të NP. ”Ambienti” për vitin 2026. **2**. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	16.02. 2027		25.02. 2027

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa.**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Mars	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2026. 2. Njoftimi me Raportin e Performances për vitin 2026. 3. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi.	29.03. 2027	1. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2026. 2. Njoftimi me Raportin e Performances për vitin 2026. 3. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	19.03. 2027		24.03. 2027

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Prill	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2027, 2. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	28.04. 2027	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2026, 2. Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	19.04. 2027	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e parë (Janar - Mars) të vitit 2027, 2. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2026.	22.04. 2027

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Maj	1. Njoftim me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2030 2. Diskutim për Hartimin e Projekt Rregullores për	27.05. 2027	1. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2030 2. Diskutim për Hartimin	19.05. 2027	1. Njoftimi me Qarkoren Buxhetore nr.1 të Ministrisë së Financave për kufijtë preliminar të përgatitjes së Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2030	25.05. 2027

	emërimin e institucioneve kulturore, sportive, arsimore, shëndetësore dhe Institucioneve tjera të Komunës së Istogut. **4.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi		e Projekt Rregullores për emërimin e institucioneve kulturore, sportive, arsimore, shëndetësore dhe Institucioneve tjera të Komunës së Istogut. **4.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi		2. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për vitin 2027.	
Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Qershor	Mbledhja solemne e K.K. për nder të ditës së çlirimit të Istogut **1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore	28.06 2027 28. 06 2027	**1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028-2030, **2.** Shqyrtim i Propozim	18. 06. 2027	**1.** Raporti mbi realizimin e procesit të kthimit. **2.** Shqyrtimi i Raportit të punës i Zyrës për	23. 06. 2027

	2028-2030, **2.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi		Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi		Komunitete. **3.** Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027.	
Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Korrik	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2027.	28 .07. 2027	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2026.	20.07. 2027	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit	26.07. 2027

	2. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2027, **4.** Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2026 dhe Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP. **5.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesat nga ekzekutivi		**2.** Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2025, **4.** Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2026 dhe Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP. **5.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesat nga ekzekutivi		fiskal 2026. 3. Shqyrtimi i raportit financiar për tremujorin e dytë të vitit fiskal 2026 **4.** Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë të vitit 2027,	
Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**

Gusht	**Pushim**	**Pushim**	**Pushim**	**Pushim**	**Pushim**	**Pushim**
Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Shtator	Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2028-2030. **1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2028-2030 **2.** Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2026 dhe Planit të veprimit. **3.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	__.09. 2027 27.09. 2025	**1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2028-2030. **2.** Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Brendshem për vitin 2026 dhe Planit të veprimit. **3.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	20.09. 2027	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit **2.** Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës për Komunitete për 6 mujorin e parë të vitit fiskal 2027. 3. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit	23 .09. 2027

Muaj	Aktivitetet e Kuvendit	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa	Data	Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete	Data
Tetor	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2027. **2.** Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028. **3.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	28.10. 2027	**1.** Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2027. **2.** Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028. **3.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	19.10. 2027	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Zyrës për Komunitete për vitin 2026. 3. Shqyrtimi i raportit financiar për 3 mujorin e tretë (korrik-shtator)të vitit fiskal 2026.	25.10. 2027

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Nëntor	**1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028. **2.** Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba. **3.** Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2028. **5.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	26.11 2027	**1.** Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2028. **2.** Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoba. **3.** Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për caktimin e normave për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2028. **5.** Shqyrtim i Propozim Vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi	18.11. 2027	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i raportit të zyrës për komunitete për vitin 2026. 3. Shqyrtimi i projektvendimeve dhe kërkesave të ekzekutivit. 4. Shqyrtimi i Draft Planit Vjetor të Punës së Komisionit për Komunitete për vitin 2027.	25.11. 2027

Muaj	**Aktivitetet e Kuvendit**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Politikë e Financa**	**Data**	**Aktivitetet e Komitetit Për Komunitete**	**Data**
Dhjetor	**1.** Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit. **2.** Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSB. **3.** Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit për vitin 2027, **4**. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2028, **5**. Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e	27.12. 2027	**1.** Njoftimi me Planit vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit. **2.** Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSB. **3.** Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit për vitin 2027, 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2028, **5.** Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e	16.12. 2027	1. Raport mbi zbatimin e procesit të kthimit 2. Shqyrtimi i raportit të zyrës për komunitete. 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Zyrës për Komunitete për 6 muajt e tjerë të vitit fiskal 2027. 4. Shqyrtimi i Projekt rregullores për Tatimet, Taksat dhe Gjobat	22.12. 2027

	nënshkruara publike, nga Prokurimi. **6.** Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për taksa Ngarkesa dhe Gjoba.		nënshkruara publike, nga Prokurimi. **6.** Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për taksa Ngarkesa dhe Gjoba.			

Sqarim:

Grupi punues për hartimin e Planit vjetor për punën e Kuvendit Komunal me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar të gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore të nivelit qendror e të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe kryetarit të Komunës dhe me përpikëri dhe përkushtimin më të madh i ka përfshirë në këtë planë si aktivitete me qëllim që kuvendi të jetë sa më funksional dhe përgjegjës në realizimin e kërkesave të qytetarëve ,anëtarëve të Kuvendit ,KPF-së, KK, dhe të kërkesave dhe përgjegjësive të kryetarit të Komunës. Mirëpo, sigurisht që dinamika e këtij plani gjatë zbatimit mund të pësoj ndryshime dhe plotësime sipas nevojës dhe paraqitjes së kërkesave të arsyeshme qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës apo edhe përgjegjësive të tjera që dalin nga miratimi ligjeve të reja dhe akteve tjera nënligjore.

Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027:

1. Enver Rugova, Kryesuesi i Kuvendit Komunal;
2. Driton Alihajdaraj, Drejtor i Administratës;
3. Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për punë Profesionale të Kuvendit të Komunës;
4. Arianit Selmanaj, anëtar e Kuvendit nga LDK;
5. Nexhmedin Balaj, anëtare i Kuvendit nga PDK;
6. Floriana Maxharraj, anëtar i Kuvendit nga LVV;
7. Fjolla Ukaj, anëtar i Kuvendit nga AAK;
8. Lulzim Shoshi, anëtar i Kuvendit i pavarur,

9. Elvira Musollaj, anëtar e Kuvendit nga IRDK;
10. Rexhë Mulaj, anëtar nga shoqëria civile.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Plani Komunal për Ri integrimin e Qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve në Istog 2026 - 2028

Nëntor 2026

Shkurtesat

ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
APRK	Agjensioni i Punësimit i Republikës së Kosovës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
DRPRIH	Departamenti për Ri integrim të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
EPPRM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim për Mosbraktisje
KA	Komisioni për Ankesa
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KKR	Komisioni Komunal për Ri integrim
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës,Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
PR	Person i Riatdhesuar
PIR	Plani Individual i Ri integrimit
PII	Plani Individual i Integrimit
QAP	Qendrat e Aftësimit Profesional
QPS	Qendrat për Pune Sociale
SMR	Sistemi për Menaxhimin e Rasteve
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
ZP	Zyrat e Punësimit
ZGJC	Zyra e Gjendjes Civile

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka aprovuar Rregulloren (QRK) Nr. 07/2026 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve).
Në kuadër të Agjendës Evropiane të Kosovës, kriteret nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave të përcaktuara në Bllokun 0, Ri pranimi dhe Ri integrimi tashmë janë përmbushur. Gjatë hartimit të Strategjisë për Ri integrim, janë adresuar të gjitha kërkesat që dalin nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Strategjia e Ri integrimit ka për qëllim ri integrimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar përmes avancimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një sistemi efektiv dhe efikas të shërbimeve, të fokusuar në nevojat e të kthyerve.

Strategjia, si dokument qeveritar i politikave të ri integrimit është obligative të zbatohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë është paraparë edhe hartimi i Planeve Komunale për Ri integrim të qëndrueshëm. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale si dhe me përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare, si Grup Punues, kanë hartuar Planin Komunal për ri integrim të qëndrueshëm dhe Integrimin e të huajve për Komunën e Istogut.

Plani i Veprimit përmban objektivat, aktivitetet konkrete dhe masat për arritjen e objektivave, përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv, cakëton kornizën kohore për realizimin e secilit aktivitet, koston e përafërt financiare për zhvillimin e aktiviteteve, indikatorët matës të objektivave dhe aktiviteteve dhe mjetet e verifikimit.

Plani është hartuar në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 07/2026 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe bazuar në Rregulloren për Integrimin e të Huajve (Rregullore (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve) dhe Planit të veprimit në nivel shtetëror, në bashkëpunim të ngushtë me MPB/DRPRH si institucion përgjegjës për ri integrimin në nivel nacional, dhe në vetë ngritjen strukturën e saj, mirëpo duke pasur parasysh se ka të bëjë me nevojat e personave të riatdhesuar në Komunën e Istogut, përmban edhe aktivitetet specifike për vetë komunën dhe është e bazuar në të dhënat e siguruara nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim. Kështu, në këtë Plan është mundësuar integrimi maksimal i gjitha aktiviteteve për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Istogut.

Plani Komunal i Veprimit për riintegrimin dhe integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe të huaj 2026-2028								
Objektivi 1:			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit të ri integrimit për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave te riatdhesuar dhe integrimin e të huajve			• *Janë identifikuar nevojat e grupeve të cenueshme dhe shërbimet ofrohen bazuar në planin individual të riintegrimit dhe te integrimit;* • *Shërbimet e riintegrimit dhe integrimit monitorohen sistematikisht dhe ndërmerren masat e nevojshme përmirësuese;* • *Është arritur riintegrimi dhe i integrimit qëndrueshëm socio ekonomik i grupeve të cenueshme;*			*40%* *50%* *30%*	*60%* *70%* *50%*	*80%* *80%* *70%*
#	**Masa**	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
1.1	Identifikimi i nevojave të grupeve të cenueshme;	1. Realizimi i vizitave në familjet e kthyera, apo të posa ardhurve të huaj brenda 72 orëve pas kthimit, apo pas marrjes së statusit/leje qëndrimit në Kosovë, bashkërisht me përfaqësuesin e DRPRIH dhe QPS; 2. Intervisto familjen dhe plotëso	NR. i familjeve të cenueshme të kthyera, dhe të huaja në komunë Nr. vizitave të realizuara nga ekipi për VN Nr. i FVN të plotësuar Nr. i formularëve të vendosur në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS DRPRIH/MPB Specialist shëndetësor Policia në komunitet - (Sipas nevojës) Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të	KA	Në vazhdimësi	Raportet nga tereni FVN i Plotësuar dhe nënshkruar nga palët SMR

		formularin e Vlerësimit të Nevojave; 3. Vendos FVN të skanuar në SMR			huajve në Kosovë			
1.2	Hartimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit, bazuar në pakot standarde të shërbimeve dhe nevojat e identifikuara ne FVN;	Harto Planin Individual të ri integrimit dhe integrimit për secilin person dhe familje të cenueshme, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë përkatëse komunale; Vendose PIR/PII të skanuar në SMR;	Nr. i Planeve Individuale të ri integrimit dhe integrimit, të hartuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Planet Individuale të ri integrimit dhe integrimit në SMR
1.3	Zbatimi i planit individual të ri integrimit dhe integrimit përmes ofrimit i shërbimeve të ri integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Këshillo personin e riatdhesuar dhe të huajin për parashtrim të kërkesave dhe informoje për afatet ligjore te parashtrimit te kërkesave; Ndihmo PR në plotësimin e kërkesave dhe dokumentacionit; Bashkëpuno me drejtoritë përkatëse komunale për	Nr. i kërkesave te parashtruara, bazuar në PIR; Nr. dhe llojet e skemave të mbështetjes; Nr. i kërkesave dhe përfitimeve të regjistruara ne SMR;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse DRPRIH/MPB ZP QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	BRK - Buxheti i ri integrimit dhe integrimit	Në vazhdimësi	Raportet e rregullta Kërkesat e parashtruara SMR

		sigurimin e shërbimeve të nevojshme; Regjistro kërkesat dhe përfitimet në SMR;						
1.4	Monitorimi dhe vlerësimi periodik i ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm për grupet e cenueshme;	Monitoro në baza mujore zbatimin e PIR; Vlerëso në baza tremujore skemat e ofruara, ndikimin e tyre dhe nevojat për plotësime apo ndryshime të skemave për arritjen e ri integrimit të qëndrueshëm dhe integrimit;	Nr. i raporteve mujore të monitorimeve dhe vlerësimeve; Raporti tremujor i vlerësimit të ndikimit te skemave të ri integrimit dhe integrimit, me rekomandimet konkrete për masa shtesë, në rast nevoje;	ZKKK DRPRIH/MPB	Drejtoritë komunale përkatëse ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e tremujore të monitorimit dhe vlerësimit
1.5	Vlerësimi përfundimtar i ri integrimit dhe integrimit dhe mbyllja e rastit;	Vlerëso gjendjen përfundimtare dhe nivelin e ri integrimit dhe integrimit te PR sipas PIR; Mbylle rastin në dokumentacion fizik; Mbyll rastin në SMR- konstato - ri integrim / integrim i	Nr. i raporteve të vlerësimit përfundimtar për secilin person/familje; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike; Numri i rasteve të mbyllura në dosje fizike	ZKKK	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e mbylljes së rasteve pas 18 muajve; Dosjet fizike të PR, të mbyllura SMR

		qëndrueshëm;	SMR					
Objektivi specifik: 2			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve			• *Sistemi i referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal është i vendosur dhe funksional;* • *Numri i rasteve të referuara tek autoritetet relevante komunale, bazuar në profilin e tyre është rritur;* • *Rritet numri i drejtorive komunale të ndërlidhura me SMR*			*40 %* *40 %* *30 %*	*70%* *75%* *60 %*	*90%* *90%* *80 %*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
2.1	Vendosja e një sistemi funksional të referimit dhe koordinimit ndërmjet akterëve komunal;	Koordino ndihmën dhe mbështetjen me drejtoritë relevante komunale, ne baza ditore, për secilin rast; Realizo takime te rregullta dhe takime ad-hoc, diskuto rastet që kërkojnë zgjidhje;	Nr. i rasteve të referuara ne drejtorit përkatëse komunale; Nr. i takimeve te rregullta dhe numri i rasteve te diskutuara; Nr. i takimeve ad –hoc dhe numri i rasteve te diskutuara;	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB MAPL MFPT MSH MBPZHR QPS ZP Drejtoritë komunale përkatëse Qendra e Shëndetit mendor Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin personave të riatdhesuar dhe integrimin e të	KA	Në vazhdimësi	SMR Raportet e rregullta nga tereni Raportet e rregullta nga DRPRIH/MPB ZKKK

					huajve në Kosovë			
2.2	Profilizimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, vlerësimi i nevojave pas arritjes në komuna;	Pranimi në zyrë i personave të riatdhesuar apo të huaj; Intervisto të riatdhesuarin/të huajin, parashtro pyetje rreth nevojave dhe mundësive të tij/saj; Krijo profilin e secilit person të kthyer apo te huaj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj; Vendos profilin dhe nevojat në SMR;	Nr. i personave të lajmëruar në ZKKK; Nr. i personave të intervistuar; Nr. i dosjeve me profilin personave të riatdhesuar dhe te huaj; Nr. i personave me nevojat e vlerësuara; Nr. i personave me profilin e vendosur ne SMR	ZKKK DRPRIH/MPB	DRPRIH/MPB ZP Drejtoritë përkatëse komunale	KA	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR
2.3	Referimi i personave të riatdhesuar dhe të huajve tek autoritetet relevante komunale bazuar në nevojat dhe profilin e tyre;	Refero personat në drejtoritë përkatëse për marrjen e shërbimeve p.sh: Refero në ZGJC personat qe kanë nevojë për dokumentacion civil; Refero personat e kthyer, apo të huaj në ZP që të	Nr.i personave të referuar në drejtoritë përkatëse; Nr .i personave te referuar në ZGJC; Nr.i personave te referuar në ZP; Nr.i personave te	ZKKK	DRPRIH ZP QPS QAP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus	KA	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

		regjistrohen si punëkërkues; Refero personat e kthyer apo të huaj të cenueshëm në QPS; Refero në DKA personat e kthyer apo të huaj që kanë fëmije për informim dhe asistimin e tyre për regjistrimin e tyre në shkolla;	referuar në QPS; Nr.i personave te referuar në DKA;		riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
2.4	Përmirësimi i sistemit të këshillimit të personave të riatdhesuar apo të huaj pas arritjes në komunë;	Bazuar në profilin dhe nevojat, këshillo ata për mundësitë e përfitimit nga shërbimet publike dhe skemat e ri integrimit dhe të integrimit; Këshillo dhe oriento ata se cilat dokumente ju nevojiten për çfarë shërbimi; Ndihmo ne përgatitjen dhe kompletimin e kërkesave;	Nr. i personave të këshilluar nga ZKKK Nr. i personave qe janë ndihmuar për përgatitjen dhe kompletimin e dokumenteve	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP ZP QAP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK SMR

		Këshillo për respektimin e afateve dhe detyrimet ligjore; Njofto ata për pasojat ligjore të ri emigrimit;						
2.5	Ndërmarrja e masave me akterët relevant për gjurmim, referim dhe këshillim të personave të riatdhesuar dhe të huaj;	Vendos sistem të bashkëpunimit të rregullt me Policinë në komunitet, me grupet në komunitet, me shkollat, organizatat; Kërko që të informohesh nëse ndonjë person apo familje është kthyer/ apo person apo familje e huaj ka marre statusin e mbrojtjes ndërkombëtare apo leje qëndrim, e nuk është identifikuar në SMR dhe/apo nuk është lajmëruar në zyrën tuaj; Kontakto personin e kthyer apo te huajin informo për mundësitë e	Takimet e rregullta me akterët relevant Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që identifikohen si rezultat i këtij bashkëpunimi	ZKKK	DRPRIH Policia e Kosovës Shkollat ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e DRPRIH/MPB ZKKK Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të identifikuar

		mbështetjes, refero në institucionet përkatëse;						
2.6	Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit të referimit dhe koordinimit;	Realizo takime te rregullta me ZKKK; Diskutoni për referimin dhe koordinimin e rasteve; Analizo sistemin e referimit dhe koordinimit; Vlerëso gjendjen aktuale dhe Rekomando masa përmirësuese, në rast nevoje;	Nr. i takimeve të rregullta	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP Drejtoritë komunale përkatëse Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet monitoruese
2.7	Referimi i rasteve pas periudhes 12 mujore sipas legjislacionit në fuqi.	Identifikimi i personave / familjeve qe kane nevoje per mbeshtetje pas 12 muajve. Ndërmarrja e veprimeve për planifikim buxhetor për vazhdimin e akomodimit dhe masave tjera te nevojshme pas 12 muajve.	Vizita personave / familjeve në skemën e akomodimit dhe me nevoja specifike pas periudhes 12 mujore Takime dhe informim për rastet me drejtoritë përgjegjëse në mënyrë që të bëhet planifikimi buxhetor	ZKKK QPS Drejtoritë përgjegjëse	DRPRIH ZP	/	Në vazhdimësi	Raporte të rregullta

Objektivi specifik 3			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik			• *Numri i punëkërkuesve të riatdhesuar apo te huaj të profilizuar dhe të këshilluar për zhvillimin në karrierë;* • *Numri i të riatdhesuarve/huajve të punësuar;* • *Numri i përfitueseve të vetëpunësimit dhe shërbimeve të konsulencës;* • *Numri i përfituesve nga skemat e aftësimit profesional;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve përfitues të grandeve bujqësore dhe këshillimeve në fushën e bujqësisë;* • *Numri i të riatdhesuarve/te huajve të mbështetur nga komuna me material dhe mjete bujqësore;* • *Zgjerimi i fushave të aftësimit profesional në përputhje me nevojat e tregut*			***60%***	***70%***	***90%***
%	***Masat***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
3.1	Regjistrimi i të riatdhesuarve/të huajve si punëkërkues në Zyrat e Punësimit;	Prano në zyrë personin e riatdhesuar/të huaj; Regjistro personat e riatdhesuar/te huaj si punëkërkues;	Nr. i personave të riatdhesuar apo te huaj të regjistruar si punëkërkues;	APRK ZP	DRPRIH/MPB ZKKK QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Raportet e ZKK

		Informo ata për të drejtat e tyre dhe mundësitë e mbështetjes me MATP; Informo ata për mundësitë e tyre në baze të legjislacionit në fuqi;			me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
3.2	Profilizimi dhe këshillimi për zhvillim në karrierë i punëkërkueseve të riatdhesuarve apo te të huajve;	Intervisto atë, parashtro pyetje rreth mundësive dhe nevojave të tij/saj; Vlerëso dhe evidento nevojat e tij/saj Krijo profilin e secilit person të kthyer apo të huaj Këshillo ata për orientim ne karriera, bazuar ne aftësitë dhe mundësit e tyre Krijo një dosje për secilin person te riatdhesuar apo te huaj Vendos shënimet në SMR	Numri i personave të riatdhesuar, te huaj të cilëve u janë vlerësuar nevojat e tij/saj; Nr i dosjeve fizike të personave të riatdhesuar apo te huaj që janë këshilluar në ZP dhe nevojat e tyre jane evidentuar; Numri i të riatdhesuarve apo te huajve punëkërkues ku janë vendosur shënimët për profilizim dhë këshillim në SMR	ZP	ZKKK QAP	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP Numri i dosjeve Shënimët dhe raportet nga SMR
3.3	Punësimi i të	Ndërmjetëso në	Numri i rasteve të	ZP	DRPRIH	/	Në	Raportet e ZP

	riatdhesuarve apo te huajve përmes ndërmjetësimit në punësim;	punësim personat e riatdhesuar apo ata te huaj të përgatitur për tregun e punës; Evidento të dhënat relevante në SMR;	ndërmjetësuara Numri i rasteve të punësimit të riatdhesuarve apo te te huajve me ndërmjetësim Të dhënat për ndërmjetësim dhe punësim në SMR		ZKKK APRK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë (donatoret)		vazhdimësi	me të dhënat mbi numrin e rasteve të ndërmjetësimit dhe punësimit të personave të riatdhesuar apo atyre te huaj
3.4	Trajnimi në punë dhe punësimi i të riatdhesuarve apo te te huajve përmes subvencionimit të pagës;	Ndërmjetëso për trajnim përmes punës personat ne nevojë për përgatitjen për tregun e punës; Monitoro mbarëvajtjen e trajnimit dhe punësimit;	Numri i rasteve të ndërmjetësuara për trajnim dhe përgaditje për tregun e punës; Numri i rasteve të monitoruara	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Bizneset Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP dhe QAP
3.5	Vetëpunësimi i të riatdhesuarve apo te të huajve përmes financimit të planeve të biznesit;	Informo këta persona për mundësitë dhe kushtet e përfitimit nga kjo skemë; Informo keta persona kur thirrja të jetë e hapur për aplikim; Ndihmo këta persona në kompletimin e	Numri i të riatdhesuarve apo te te huajve që informohen për mundësitë dhe kushte e përfitimit përmes planeve të biznesit	ZP	DRPRIH ZKKK QAP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		dosjes për aplikim;						
3.6	Aftësimi profesional i personave të riatdhesuar dhe te te huajve në përputhje me kërkesat e tregut të punës;	Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që kanë nevojë për aftësim profesional; Identifiko profilin e tyre dhe orientoj ata ne profesionet adekuate me prirjet dhe dëshirat e tyre; Referoj ata në QAP përkatëse;	Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që vijojnë aftësimin profesional Numri i të riatdhesuarve apo te huajve të profilizuar dhe orientuar për AP Numri i të riatdhesuarve apo te huajve që referohen në QAP	ZP QAP	DRPRIH ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Bizneset	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZP me të dhënat e të riatdhesuarve dhe të huajve që vijojnë aftësimin profesional
3.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP);	Monitoro në baza të rregulltambarëvajtjen e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP); Vlerëso ndikimin e tyre ne përgatitjen dhe ri integrimin e PR;	Numri i të riatdhesuarve de te huajve që përfitojnë nga MATP ; Të dhëna për ndikimin e MATP në riintegrimin dhe integrimin e tyre	ZP DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	ZKKK APRK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet periodike te monitorimit dhe vlerësimit të përgatitura nga DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)
3.8	Mbështetja me grante, mjete dhe materiale bujqësore, trajnimi dhe këshillimi i të riatdhesuarve dhe te huajve në	Informimi i të ketyre personave për mundësitë e përfitimit të granteve bujqësore; Përfshirja e të	Numri i të riadhesuarve dhe te huajve që kanë përfituar grante bujqësore	Drejtorati i Bujqësisë dhe Zhvillimit rural/ Komuna	ZKKK AZHBR/MBZHR Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK me të dhënat për rastet kur përfitues të granteve janë personat e riatdhesuar

	zonat rurale;	riatdhesuarve dhe te huajve si përfitues i granteve bujqësore;			ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
Objektivi specifik 4			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjës sociale të personave të riatdhesuar dhe te huajve			*Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitim nga shërbimet sociale;* *Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve përfitues të asistencës sociale;* *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj në nevoje që kanë pranuar trajtim psiko-social;* *Numri i personave të riatdhesuar dhe personave te huaj të përfshirë në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative ;* *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që u është siguruar banim i qëndrueshëm nga komunat (pas periudhës 12 mujore);* *Numri i të riatdhesuarve dhe te te huajve që kanë përfituar asistencë në sigurimin e kushteve për banim;*			*40 %* *50%* *%* *10 %* *10%* *30%*	*75%* *70%* *30%* *30%* *30%* *50%*	*90%* *90%* *50%* *60%* *50%* *60%*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
4.1	Informimi dhe këshillimi social i personave të riatdhesuar dhe te huajve për	Prano në zyre personin e riatdhesuar apo te huaj, te referuar nga ZKKK;	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve që u ofrohet këshillë për shërbimet dhe skemat sociale;	QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK

	mundësitë e përfshirjes në skemat sociale;;	Informo atë për shërbimet dhe skemat sociale; Këshilloje atë për procedurat dhe dokumentet e nevojshme për përfshirje sociale; Menaxho rastin deri ne vendosjen ne sistemin social; Regjistroi ne bazën e te dhenave (SNS) rastin/skemën e përfitimi;	Numri i rasteve që monitorohen derisa vendosen në sistemin social Vendosja e të dhënave për të riatdhesuarit dhe te huajt që përfitojnë nga skemat sociale në SMR		Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat veKKRndore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
4.2	Asistimi i personave të riatdhesuar dhe te huaj në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.	Të përfshihet zyra e gjendjës civile si pjesë e KKR-së. Asisto personat e riatdhesuar dhe personat e huaj për sigurimin e dokumenteve te nevojshme për aplikim skemat sociale si dhe ndihma juridike falas Menaxho dhe monitoro rastin në	Vendimi i KKR-së plotësuar dhe ndryshuar nga komuna Numri i personave të riatdhesuar dhe te huajve që asistohen për përgaditje të dokumentacionit për aplikim në skemat sociale dhe ndihme juridike falas Numri i rasteve të monitoruara deri në	Komuna KKR QPS	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal) ZP Drejtoritë përkatëse komunale Agjensioni për ndihmë juridike falas	/	Në vazhdimësi	Raportet nga QPS Raportet e ZKKK

		shqyrtimin e kërkesës dhe vendimin përfundimtar; Regjistroi ne SMR rastin/skemën e përfitimit;	shqyrtim të kërkesës deri te vendimi përfundimtar Vendosja e të dhënave për numrin e të riatdhesuarve dhe te huajve që përfitojnë nga skemat sociale në SMR					
4.3	Sigurimi i banimit të qëndrueshëm	Monitoro rastet që janë të akomoduar me qera nga programi i ri integrimit dhe i integrimit Këshillo dhe ndihmo rastet ne nevojë për aplikim për banim social Siguro banim të qëndrueshëm pas skadimit te qirasë Regjistro në SMR rastin e përfitimit	Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve të asistuara për aplikim për banim social Numri i rasteve që u sigurohet banim i qëndrueshëm Të dhënat në SMR	ZKKK DRPRIH/MPB (Koordinatori Rajonal)	QPS Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e të riatdhesuarve që kanë përfituar banim të qëndrueshëm

4.4	Trajtimi psikologjik dhe asistenca psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te huaj në nevojë;	Identifikimi i rasteve dhe vlerësimi i nevojave për trajtim psiko-social Ofrimi i ndimës psiko-sociale për personat e identifikuar Monitorimi i rasteve që u ofrohet ndihmë psiko sociale Regjistrimi i të dhënave për rastet dhe formën e ndihmës psiko-sociale për personat e riatdhesuar dhe te te huajve Sigurimi i transportit për trajtim	Numri i rasteve të identifikuara në nevojë për ndihmë psiko-sociale Numri i rasteve që marrin ndihmë psiko sociale Numri i rasteve të monitoruara Numri i rasteve dhe të dhënave të regjisturuara në SMR	ZKKK QPS	Qendra e shëndetit mendor Shkollat Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK për numrin e te riatdhesuarve që janë mbështetur dhe formën e ndihmës psiko sociale Raportet e Organizatave vendore dhe ndërkombëtare
4.5	Sigurimi i kushteve të banimit përmes renovimit, rindërtimit dhe mobilimit te shtëpive të personave të riatdhesuar dhe te huaj;	Këshillo personat e riatdhesuar dhe te huajt për mundësit e përfitimit nga skema e renovimit, rindërtimit dhe mobilimit të shtëpive Ndihmo ata në kompletimin e dosjes	Numri i personave të riatdhesuar dhe te huaj që janë informuar dhe asistuar për mundësitë e përfitimit nga skema e renovimit, ndërtimit dhe mobilimit të shtëpive; Numri i rasteve/dosjeve të proceduara për	KKR	ZKKK DRPRIH/MPB MMPHI Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raportet e DRPRIH Të dhënat nga SMR

		për aplikim ne këto skema Procedo dosjet për shqyrtim nga KKR Përcjelle lënden për ekzekutim ne DRPRIH përmes koordinatorit rajonal Regjistro rastin dhe vendos dosjen ne SMR	shqyrtim në KKR; Numri i vendimeve të KKR për këtë skemë; Numri irasteve të përcjella në DRPRIH për ekzekutim; Vendosja e të dhënave në SMR për numrin e rasteve të aplikimit dhe vendimeve përfundimtare të përfitimit nga kjo skemë.		riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
4.6	Përfshirja (Informimi) e të kthyerve dhe te huajve në aktivitetet kulturore, sociale, rekreative dhe inovative;	Informo dhe përfshij personat e riatdhesuar dhe te huaj në aktivitete kulturore, sociale, rekreative dhe inovative, te organizuara ne komunën tuaj Bashkëpuno me organizatat për realizim te aktiviteteve te tilla ne komunën tuaj	Të dhënat mbi informimin e të riatdhesuarve dhe te huajve për përfshirje në aktivitete sociale dhe kulturore në nivel komunal Të dhënat mbi bashkëpunimin me organizata dhe projekte me qëllim përfshirjen e të riatdhesuarvedhe te huajve në aktivitete të ndryshme	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë Mediat	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
Objektivi specifik 5			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huajve në të sistemin edukativo arsimos			*Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj të përfshirë në nivelin përkatëse të shkollimit;*			*90%*	*100%*	*100%*

			Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset e gjuhës dhe mësimin plotësues; *Numri i rasteve të reagimeve të ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes;* *Numri i programeve mësimore të rishikuara të shpërndara në shkolla;* *Numrin i të rriturve të riatdhesuar dhe te huaj, që kanë mësuar shkrim- lexim;* *Numri i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes në mësim;*			*50%* *50%* *10%* *50%* *80%*	*60%* *75%* *50%* *60%* *85%*	*85%* *80%* *80%* *70%* *97%*
#	***Masa***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
5.1	Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në nivelin përkatës të shkollimit;	Merr infromatat nga ZKKK për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj që duhet të përfshihen në sistemin arsimor Vlerëso nivelin e njohurive te nxënësit te riatdhesuar dhe atyre te huaj Përcakto nivelin përkatës te shkollimit Akomodo nxënësit	Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe atyre te huaj që janë përfshirë në sistemin arsimor Raportet e vlerësimit të nevojave arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Raportet e regjistrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj	DKA Shkollat	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Shkollat Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë EPPRM (Ekipi për parandalimin dhe reagim për mosbraktisje)	/	Në vazhdimësi	Raportet nga DKA Raportet nga ZKKK

		në klasat përkatëse						
5.2	Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimit plotësues për fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj;	Identifiko nxënësit që kanë vështirësi në përdorimin e gjuhëve zyrtare Organizo kurse të gjuhës në shkollën ne të cilën nxënësit vijojnë mësimin; Organizo mësimin plotësues bazuar në nevojat e nxënësit	Numri i nxënësve te kthyer ne komune; Numri i nxënësve të identifikuar me vështirësi ne përdorimin e gjuhëve zyrtare Numri i nxënësve që kanë vijuar kurset dhe mësimin plotësues	DKA Shkolla përkatëse	DRPRIH/MPB ZKKK Shkollat Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Testet vlerësuese dhe raportet përkatëse
5.3	Nostrifikimi i dokumenteve te nxënësve te riatdhesuar dhe te huaj;	Nostrifiko dokumentet shkollore të nxënësve të kthyer dhe te huaj Ofro ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumentacionit të nevojshëm për nostrifikim	Numri i nxënësve që kanë nostrifikuar dokumente Numri i rasteve që u është ofruar ndihmë në përkthim dhe verifikim të dokumenteve	DKA MASHTI	DRPRIH/MPB Shkolla përkatëse Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportete e DKA për rastet e nostrifikimit të dokumenteve
5.4	Funksionalizimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe	Organizo takime të rregullta me ekipet për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave Diskuto për gjendjen	Numri i takimeve të rregullta të ekipit për parandalim dhe reagim kundër braktisjes se shkollave nga fëmijët e riatdhesuar dhe te huaj Të dhënat për aktivitetet	Shkollat DKA	KKR ZKKK Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus	/	Në vazhdimësi	Raprotet nga Shkolalt dhe DKA

	te huaj;	e fëmijëve te riatdhesuar dhe te huaj, identifiko fëmijët ne rrezik për braktisje te shkollës Ndërmerr masa konkrete ne bashkëpunim me prindërit dhe shkollën për parandalim te kësaj dukurie Përgatit raporte të rregullta dhe ndaj ato me MASHTI dhe DRPRIH	dhe bashkëpunimin me prindër dhe akterët tjerë		riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë EPPRM (Ekipi për parandalimin dhe reagim për mosbraktisje)			
5.5	Hartimi dhe zbatimi i planeve të riintegrimit dhe te integrimit të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj në arsim, bazuar në nevojat e tyre;	Vlerësimi i njohurive arsimore të nxënësve të riatdhesuar dhe te huaj Identifikimi i nevojave për mësim plotësues për nxënësit e riatdhesuar dhe te huaj Hartimi i planeve individuale për integrim në arsim të fëmijëve të riatdhesuar dhe te	Numri i rasteve të vlerësimit të njohurive arsimore të fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj Të dhënat për mësim plotësues për nxënësit e riatdheasuar dhe te huaj Numri i fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj për të cilët janë hartuar planet individuale për integrim në sistemin arsimor	Shkolla DKA	DRPRIH/MPB ZKKK QPS Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet nga shkollat

		huaj						
5.6	Zhdukja e analfabetizmit të personave të riatdhesuar dhe te huaj; Organizimi i mësimit plotësues për familjet e riatdhesuara	Identifiko personat e riatdhesuar dhe te huaj që nuk dijnë shkrim – lexim Dërgo listën ne DRPRIH përmes koordinatoreve rajonal	Numri i të riatdhesuarve dhe te huajve analfabetë; Masat e ndërmarra për zhdukje të analfabetizmit tek të riatdhesuarit dhe te huajt;	ZKKK DRPRIH/MPB	DKA QPS MASHTI Shkollat Qendrat Mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK Raprotete e DRPRIH
5.7	Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikave të përfshirjes në shkollim për të riatdhesuarit dhe te huajt;	Monitoro rregullisht përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në shkollim Vlerëso zbatimin e politikave të përfshirjes së fëmijëve të shkollim Përgatit raport te monitorimit dhe përcjell nga një kopje ne MASHT dhe DRPRIH	Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të përfshirjes së fëmijëve të riatdhesuar dhe te huaj në sistemin arsimor të Kosovës	DKA	MASHTI DRPRIH/MPB ZKKK Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e DKA Raportet e ZKKK

Objektivi specifik 6			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Integrimi social dhe informimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, si dhe komunitetit pritës			• *Numri i takimeve të grupeve të organizuara me të kthyerit në komuna për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në komunitet;* • *Numri i aktiviteteve për promovimin e procesit të riintegrimit;*			*5%* *5 %*	*30%* *40%*	*60%* *70%*
Nr.	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afatet kohore***	***Mjetet e verifikimit***
6.1	Organizimi i takimeve me të riatdhesuarit dhe te huajt për ndarjen e eksperiencave dhe vendosjen e rrjeteve në komunitet;	Organizo takime informative me te riatdhesuarit dhe te huajt; Diskuto ne këto takime me te riatdhesuarit që kanë histori për te ndare me te tjerët, për ndarjen e përvojave me te riatdhesuar tjerë	Numri i takimeve të organizuara me të riatdhesuarit dhe te huajt dhe komunitetin në nivel komunal	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK ve për takimet e organizuara dhe numri i pjesëmarrësve
6.2	Ndarja e përvojave e personave të riatdhesuar dhe te huaj gjatë procesit të integrimit përmes realizimit te aktiviteteve të ndryshme;	Organizo takime/ debate dhe përfshij të riatdhesuarit dhe te huajt të ndajnë historitë e tyre të migracionit me persona tjerë nga komuniteti i komunës tuaj, si mase e parandalimit të migrimit ilegal	Numri i takimeve të organizuara dhe përfshirja e të riatdhesuarve dhe te huajve me qëllim të ndarjes së përvojës dhe parandalim të migrimit ilegal	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK nga takimet/debatet e organizuara

					huajve në Kosovë			
6.3	Promovimi i procesit të ri integrimit dhe integrimit përmes informimit publik;	Promovo procesin e ri integrimit dhe integrimit ne komunën tuaj, përmes diskutimeve publike në radiot dhe televizionet lokale	Numri i artikujve dhe storjeve në mjetet e komunikimit (Radio, TV, Internet dhe media sociale)	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet dhe referencat nga komunikmi masiv

Objektivi specifik 7	***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***	***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Koordinimi ndërmjet akterëve lokal të përfshirë në procesin e riintegrimit te riatdhesuarve dhe integrimit të të huajve	• *Është vendosur praktika e bashkëveprimit horizontal në nivel lokal dhe ajo është efektive;*	*40%*	*60%*	*80%*
	• *Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet ZKKK dhe QPS;*	*30%*	*50%*	*80%*
	• *Është avancuar bashkëveprimi ndërmjet akterëve në nivel qendror dhe atyre lokal të kyçur në riintegrim dhe integrim;*	*50%*	*70%*	*80%*
	• *Është avancuar bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile, projektet dhe organizatat ndërkombëtare;*	*40%*	*60%*	*70%*

Nr.	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
7.1	Vendosja e kontakteve me të gjitha institucionet relevante dhe organizatat;	Krijo një bazë të dhënave (listë) me kontakte të institucioneve dhe organizatave që fushën e riintegrimit	Janë identifikuar organizatat dhe akterët që punojnë në fushën e riintegrimit dhe	ZKKK	QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe	/	Në vazhdimësi	Raportet e punë dhe bashkëpunimit me partnerë

		dhe integrimit të personave të riatdhesuar dhe te te huajve në komunë/rajon Vendos kontakte te komunikimit dhe bashkëpunimit	integrimit te personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj në komunë/rajon Kontaktet me akterë dhe organizata janë vendosur		ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
7.2	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet drejtorive komunale dhe gjithë akterëve të përfshire në nivel lokal;	Organizo takime te rregullta mujore me drejtorit relevante ne komunën tuaj, diskuto për nevojat dhe mbarëvajtjen e procesit te ri integrimit dhe integrimit Se paku një herë në tremuaj organizo takime me te gjithë akterët e ri integrimit dhe integrimit ne nivelin lokal	Numri i takimeve dhe Raportet nga takimet me drejtoritë relevante për riintegrim dhe integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj Raportet nga takimet me akterët tjerë relevant	KKR ZKKK	ZP QPS QAP Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Policia në komunitet Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
7.3	Ndarja e raporteve analitike dhe informatave relevante me të gjithë akterët e përfshirë në procese;	Ndaj raportet e rregullta me te gjitha drejtorit komunale, relevante ne ri integrim dhe integrim. Kërko dhe dërgo informata kthyese, për rastet e referuara	Shpërndarja e raporteve me drejtoritë relevante dhe partnerët tjerë Të dhënat dhe raportet e pranuara nga	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Policia në komunitet	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		ne drejtorit përkatëse	drejtroritë përkatëse		Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
Objektivi specifik: 8			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike ne nivel të komunës për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve			• *Rritja e nivelit të përfitimit nga donatorët që mbështesin riintegrimin në nivel dhe lokal;* • *Numri i projekt-propozimeve të zhvilluara dhe të financuara nga donatorët e huaj;* • *Rritet numri i projekteve të realizuara;* • *Vendosja e mekanizmit adekuat për koordinim të asistencës teknike dhe donacioneve bazuar në prioritetet e strategjisë;* • *Projektet dhe iniciativat që mbështesin fushën e riintegrimit monitorohen vazhdimisht;*			*40%* *%* *%* *30%* *%*	*60%* *30%* *30%* *50%* *30%*	*80%* *50%* *50%* *70%* *40%*
#	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
8.1	Identifikimi dhe sigurimi i kontakteve me të gjitha projektet e ri integrimit dhe integrimit;	Identifiko projektet e ri integrimit dhe integrimit ne komunën tuaj Siguro kontaktet e organizatave që zbatojnë projekte të ri integrimit dhe integrimit në komunën tuaj	Të dhënat për projektet që realizohen në komunën/rajonin tuaj	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.2	Vendosja e	Krijo një data bazë	Raport mbi	ZKKK	DRPRIH/MPB	/	Në	Raportet e

	sistemit për bashkëpunim dhe koordinimin e projekteve të ri integrimit dhe integrimit me përfaqësuesit e organizatave donatore dhe ofruesit e shërbimeve;	me të gjitha projektet e ri integrimit dhe integrimit ne komunën tuaj dhe organizatave qe implementojne ato Organizo takime te rregullta, se paku çdo tre muaj, me organizatat që zbatojnë projekte të ri integrimit dhe integrimit në komunën tuaj Koordino aktivitetet ndërmjet organizatave, shmang dyfishimin e shërbimeve të njëjta dhe adreso zbrazëtit përmes projekteve Refero rastet ne nevojë te organizatat sipas profilit dhe shërbimeve qe ofrojnë	projektet që zbatohen në fushën e riintegrimit dhe integrimit në komunën/rajonin tuaj; Numri i takimeve koordinuese me projektet në komunën/rajonin tuaj		ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		vazhdimësi	ZKKK
8.3	Identifikimi i nevojave të nivelit lokal për projekte në fushën e ri integrimit dhe integrimit;	Identifiko nevojat për projekte në fushën e riintegrimit dhe integrimit në komunën tuaj Informo organizatat	Nevojat për riintegrim dhe integrimit janë identifikuar dhe oprganizatat janë infromuar dhe ftuar për	ZKKK	ZP QAP QPS Drejtoritë përkatëse komunale DRPRIH/MPB	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		dhe donatoret për nevojat tuaja	bashkëpunim		Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë			
8.4	Avancimi i sistemit të shkëmbimit të informatave me donatorët në nivelin lokal;	Organizo takime me donatoret në komunën tuaj, së paku një here në vit Prezanto ne këto takime nevojat e komune tuaj për donacione në fushën e ri integrimit dhe integrimit Ndaj informata relevante me donatoret në komunën tuaj	Raporti nga takimet me donatorë; Ndarja e infromatave relevante për rintegrim dhe integrimit me donatorë dhe partnerë në komunë/rajon	ZKKK	DRPRIH/MPB Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK
8.5	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të projekteve dhe asistencës teknike;	Organizo takime për diskutim të mbarëvajtjes se projekteve Kërko raporte të rregullta nga organizatat për zbatimin e projekteve te ri integrimit dhe integrimit në komunën tuaj Vlerëso zbatimin e	Numri i takimeve me organizata, projekte dhe donatorë; Raportet e organizatave për zbatim të projekteve Vlerësimi i ndikimit të	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raportet e ZKKK

		projekteve dhe ndikimin e tyre në adresim të nevojave të komunës dhe ose të personave të riatdhesuar apo te huaj	projekteve në nevojat e komunës për riintegrim dhe integrim të personave të riatdhesuar dhe atyre te huaj					
Objektivi specifik: 9			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira të procesit të riintegrimit të personave të riatdhesuar dhe itegrimit të të huajve			• *Janë fuqizuar kapacitetet e stafit të angazhuar për zbatimin e qasjes së bazuar në nevoja dhe trajtimin e grupeve të cenueshme* • *Numri i stafit të riintegrimit dhe integrimit të trajnuar për identifikimin, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve;* • *Numri i aktiviteteve të realizuara në nivelin lokal për shpërndarjen e praktikave të mira komunale*			*20%* *20%* *20%* *20%*	*50%* *50%* *50%* *50%*	*70%* *70%* *70%* *70 %*
#	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
9.1	Pjesëmarrja aktive ne trajnimet e organizuara për ri integrim dhe integrim;	Merr pjese aktive në trajnimet e organizuara nga DRPRIH, Organizatat ndërkombëtare apo Organizatat vendore	Numri dhe tema e trajnimeve të ndjekura	ZKKK	DRPRIH/MPB KKR Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet

					integrimin e të huajve në Kosovë			
9.2	Shkëmbimi i përvojave ndërmjet akterëve lokal përmes punës së përbashkët në teren;	Punoni kohë pas kohe bashkërisht me homologet tuaj në komunat tjera, shkëmbeni përvojat dhe praktikat e mira, mësoni nga njëri tjetri për trajtimin e rasteve specifike	Numri i takimeve me homologët	ZKKK	DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga takimet
9.3	Organizimi i takimeve të rregullta ndërmjet komunave për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira;	Organizoni takime te përbashkëta me komunat e regjionit tuaj por edhe me komuna tjera Diskutoni për temat me interes në fushën e ri integrimit Adaptoni përvojat dhe praktikat e mira të komunës përkatëse	Numri i takimeve të përbashkëta dhe temat e diskutuara	ZKKK DRPRIH/MPB	ZP QPS Qendrat e shëndetit mendor Qendrat mësimore Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	/	Në vazhdimësi	Raporet e ZKKK nga trajnimet
Objektivi specifik: 10			***Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit***			***Baza***	***Caku 2026***	***2028***
Monitorimi sistematik i qasjes së orientuar në nevoja për secilin kategori të personave të			• *Numri i stafit të trajnuar në fushën e menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të pakove standarde të*					

riatdhesuar dhe te huaj, bazuar në planin individual të riintegrimit dhe integrimit			*riintegrimit dhe integrimit;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për menaxhimin e kualitetit të shërbimeve;* • *Numri i stafit relevant të trajnuar për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut;*			***%***	***30%***	***60%***
#	***Aktiviteti***	***Veprimet***	***Indikatorët***	***Institucioni përgjegjës***	***Institucioni /partneri përkrahës***	***Kosto financiare***	***Afati kohor***	***Mjetet e verifikimit***
10.1	Rritja e kualitetit të shënimeve në Sistemin elektronik të Menaxhimit të Rasteve (SMR);	Regjistro të gjitha rastet në SMR; Skano të gjithë dokumentacionin për secilin rast individual dhe vendose në SMR Sigurohu që shënimet janë të sakta dhe të plota, për secilin rast	Nr i rasteve të regjistruara në SMR Nr dhe lloji i dokumenteve të vendosura në SMR Nr i përmirësimeve dhe plotësimeve në SMR	ZKKK	DRPRIH/MPB	MPB	Në vazhdimësi	SMR
10.2	Monitorimi sistematik i shfrytëzimit dhe ndikimit të shërbimeve në ri integrim dhe integrim të qëndrueshëm;	Monitoro rastet e regjistruara në SMR, nëse kanë marr shërbimet e nevojshme dhe kanë parashtruar kërkesat, bazuar në nevojat e identifikuara në FVN Kërko informata nga DKA nëse fëmijët e kthyer janë duke vijuar mësimit	Të dhënat për rastet e monitoruara Raporte të rregullta për rastet e monitoruara	ZKKK DRPRIH/MPB	QPS ZP Drejtoritë përkatëse komunale Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë	KA	Në vazhdimësi	SMR Raportet nga tereni Raportet e ZKKK

		Siguro informata nga ZP nëse te kthyerit janë regjistruar ne ZP si punëkërkues dhe a janë qasur në skemat adekuate Kontakto të kthyerit dhe te huajt qe nuk kanë përfituar nga shërbimet Siguro informata nga menaxheret e rasteve për ndikimin e skemave në riintegim dhe integrim te qëndrueshëm						
10.3	Vendosja e një mekanizmi për monitorimin dhe raportim të komunave për zbatimin e Planeve Komunale të Ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm.	Raportimi te DRPRIH për zbatim të planit Raportimi te MAPL Për zbatim të planit	Mekanizmi për monitorim dhe raportim të zbatimit të planit komunal për riintegrimdhe integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe te huaj	ZKKK	Drejtoritë përkatëse komunale MAPL DRPRIH/MPB QPS ZP Organizatat vendore dhe ndërkombëtare me fokus riintegrimin dhe integrimin e të huajve në Kosovë		Në vazhdimësi	Raporti i zbatimit të planit komunal

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna Istog
Opština Istok
Municipal Istog

PLANI KOMUNAL PËR TRANSPORT 2026-2030

ISTOG, NËNTOR 2026

PËRMBAJTJA

1. **HYRJE - HISTORIKU I SHKURTËR I KOMUNËS.....3**

2. **POZITA GJEOGRAFIKE.....3**

3. **QASJA DHE METODOLOGJIA.....4**

   3.1 Qëllimi.....4

   3.2 Vizioni.....4

   3.3 Misioni 4

4. **OBJEKTIVAT.....5**

5. **GJENDJA E RRJETIT RRUGOR 5**

   5.1 Rrugët - rrjetit rrugor dhe qarkullimi.....5

   5.2 Kategorizimi zyrtar i rrjetit të rrugëve.....5

   5.3 Përgjegjësia mbi menaxhimin e traseve të rrugëve.....6

   5.4 Lidhshmëria e transportit në mes vendbanimeve në komunë dhe me komunat fqinjë....7

6. **RENDET E UDHËTIMIT.....8**

   6.1 Rendet e udhëtimit të linjave nder urbane.....8-9

   6.2 Rendet e udhëtimit të linjave komunale.....10-13

1. HYRJE - Historiku i shkurtër i Komunës

Në bazë të të dhënave arkeologjike, lokaliteti i Istogut përmendet dhe daton qysh nga koha antike, sipas disa burimeve historike thuhet se në pjesën e territorit në mes të Istogut të madh dhe të vogël ku bashkohen lumi i Istogut dhe lumi i Qaushit. Ka ekzistuar një koloni romake gjë që i përket lokacionit të sotëm të qytetit, po ashtu Istogu përmendet si lokacion edhe ka fundi i shek. XIV kur kjo pjesë e Dardanisë ishte nën pushtimin sllav. Gjatë kohës së sundimit turk, Istogu si vendbanim njihet me zhvillimin e mullinjve për bluarjen e drithit si dhe punëtorive për përpunimin e leshit(zhgunit)

Me dekretligj nga 30 Prilli i vitit 1942 Istogu u shpall Qytezë, në rrethin e Istogut dhe krahas funksionit ekonomik të atëhershëm, Istogu në bazë të këtij dekretligji, fiton edhe funksionin administrative. Me 29 Dhjetor të vitit 1978, Istogu shpallet Qytet me sipërfaqe të caktuar sipas planit urbanistik. Lokalitete të urbanizuara janë edhe Banja, Gurrakoci, Rakoshi, Vrella dhe Staradrani.

2 Pozita gjeografike

Komuna e Istogut ka një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe është e hapur në të gjitha anët me përjashtim të pjesës veriore e cila është e rrethuar me male të larta, Bjeshkë të thata dhe Mokna me një lartësi mbidetare deri në 2155 m (Mokna) dhe është e lidhur me rrugë të asfaltuara me të gjitha komunat e Kosovës.

Klima në këtë zonë ka karakter kontinental dhe karakter bregdetarë, por kryesisht dominon karakteri kontinental. Temperatura mesatare e vitit është rreth 10.7 ° C . Muaji më i ftohtë është muaji Janar me temperature mesatare -10 ° C . Lëvizja e ajrit ndikon në mënyrë të theksuar nga relievi, për këtë arsye shpejtësia e erës shpeshherë arrijnë gjerë në 120 km/h.

- Istogu shtrihet në anën veri-perëndimore të Kosovës dhe në pjesën veriore të Rrafshit të Dukagjinit
- Istogu kufizohet me këto komuna: Pejë, Klinë, Skenderaj, ZubinPotok, Tutinë (Serbi), Rozhajë (M.i Zi).
- Komuna e Istogut ka 6 qendra urbane (Istog, Banjë, Gurrakoc, Vrellë, Rakosh dhe Staradran). Gjithesë 50 lokalitete (fshatra).
- Komuna e Istogut posedon sipërfaqe prej 454 km² , me një lartësi mbidetare 350-400m (fusha), ndërsa lartësia më e madhe është 2155 m (Mokna).
- Me regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, të vitit 2024 Istogu ka rreth 33.000 banorë.



Harta – Territori i Istogut me vendbanime-fshatra

3 QASJA DHE METODOLOGJIA

3.1.Qellimi

Hartimi i planit komunal për transportin e udhëtarëve, është miratimi i orareve të rendit të udhëtimit për linjat komunale të transportit të udhëtareve me autobus në territorin e komunës së Istogut.

3.2.Vizioni

Krijimi i sistemit të shërbimeve të rregullta të transportit të udhëtareve, e me theks të veçanta përshtatje e linjës sipas orarit mësimor të nxënësve të shkollave të mesme.

3.3.Misioni

Krijimi i ambientit për zhvillim të sigurt, kualitativ dhe funksional të sistemit të transportit dhe kapaciteteve njerëzore në ofrimin e shërbimeve cilësore. Misioni i përgjithshëm i komunës së Istogut në sektorin e transportit është që : që të lidhë vendbanimet me qytetin dhe qendrat urbane në mes veti, ku përmes transportit publik me autobus qytetaret të kenë mundësi ta shfrytëzojnë këtë mjet për transport të sigurt, efikas dhe me ekonomik.

4. OBJEKTIVAT

- Objektiva 1- Lidhja me komunat tjera fqinjë dhe rrugët e komunës së Istogut, përmasimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së transportit.
- Objektiva 2- Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve, krijimi i ambientit të favorshëm dhe të sigurt rregullativ për ngritjen e cilësisë së shërbimeve në lëmin e transportit.
- Objektiva 3 – Përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe i mbrojtjes së mjedisit.

5. GJENDJA E RRJETIT RRUGOR

5.1 Rrugët (rrjeti rrugor dhe qarkullimi)

Të gjitha rrugët lokale kanë lidhshmëri me komunë, ku rreth 90 % e këtyre rrugëve lidhen në rrjetin e rrugëve Nacionale, Regjionale dhe Lidhëse që kalojnë për gjatë territorit të komunës, e të cilat kanë qasje të lehtë në drejtim të qytetit dhe me qendrat urbane.

Këto rrugë kryesore lokale që lidhen në rrjetin e rrugëve Nacionale, Regjionale dhe Lidhëse janë të asfaltuara. Rrugët brenda një vendbanimi (fshatit) të caktuar kanë lidhshmëri me rrugën lokale, ku shumica nga këto rrugë gjithashtu janë të asfaltuara.

Shtrirja e rrjetit rrugor në territorin e Komunës së Istogut si dhe ndërlidhja rrugore me të gjitha nivelet e hierarkisë rrugore mundëson lidhje të mira brenda juridiksionit komunal dhe me qytetet tjera fqinjë.

5.2 Kategorizimi zyrtar i rrjetit të rrugëve:

Në komunën e Istogut kryqëzohen rrugët Nacionale dhe Regjionale, që e lidhin qytetin me qendrat tjera komunale e rajonale.

- Rruga Nacionale qe kalon neper territorin e komunës është: Pejë – Mitrovicë, konkretisht kalon neper këto lokalitete te komunës Bajicë-Banjë-Gurrakoc-Serbobran-Llukafc i Thatë-Kovragë-Veriq-Bellopojë-Rakosh-Padalishtë,
- Rrugët Regjionale qe kalojnë neper territor te komunës janë: Rruga Istog – Gurrakoc – Klinë (qe komunën e Istogut ky segment e përfshinë traseja Istog-Gurrakoc-Drejë, ku pastaj lidhet me fshatin Zllakuqan qe është me territor te komunës Klinë) , rruga Bellopojë - Istog-Vrellë – Bajicë, rruga Zallq – Osojan -Rakosh – Zubin Potok, rruga Bënjë-Kashicë-Saraderan-Zallq dhe rruga Vrellë-Kaliqan-Dydesh-Novosellë (pjesa e komunës është segmenti Vrellë-Kaliqan-Dydesh).
- Ndërsa rrugët tjera janë urbane, urbane periferike dhe lokale.



Harta – rrjeti rrugor në territorin e komunës Istog

5.3 Përgjegjësia mbi menaxhimin e traseve të rrugëve

Bazuar ne dispozitat Ligjore (LIGJI NR. 04/L-179 PËR TRANSPORTIN RRUGOR dhe LIGJI NR.08/L-275 PËR RRUGËT) :

Përgjegjësitë e Ministrisë dhe Komunës në transportin rrugor të udhëtarëve

Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e:

- transportit të udhëtarëve brenda territorit të Kosovës;
- transportit të udhëtarëve jashtë territorit të Kosovës;
- transportit të udhëtarëve për qasje dhe kalim transit nëpër territorin e Kosovës.

Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit te saj si vijon:

- transportin e rregullt të udhëtarëve;
- transportin e lirë të udhëtarëve;
- transportin taksi të udhëtarëve;
- transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake.

Ligji Nr.04/L-179 për Transport Rrugor është akti themelor për menaxhimin e transportit publik të udhëtarëve në Kosovë. Ky Ligj ofron parimet bazë mbi kompetencat e Ministrisë dhe Komunës për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e transportit publik të udhëtarëve.

N**eni 6** i **Ligjit Nr.04/L-179 për Transport rrugor,** në mënyrë specifike i përcakton kompetencat e komunave sa i përket menaxhimit dhe mbikëqyrjen e Transportit Publik të udhëtarëve. Sipas nenit 6 pika 2 komunat, janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e Planeve Komunale për Transport Publik të Udhëtarëve, ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të transportit, përzgjedhjes së operatorëve të licencuar si dhe përcaktimin e relacioneve – linjave të rregullta të transportit. Komuna gjithashtu në bazë nenit 6 pika 8 e këtij ligji mund të licencojë operatorë të transportit për ushtrimin e veprimtarisë brenda territorit të saj.

KONKRETISHT

MINISTRIA e Infrastrukturës dhe Transportit është përgjegjëse për rrugët: Nacionale, Regjionale dhe Lidhëse, duke përfshirë edhe me menaxhimin, gjegjësisht caktimin e linjave dhe rendeve të udhëtimit për transportin publik të udhëtareve me autobus për gjatë këtyre traseve.

NDËRSA,

KOMUNA është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj për rrugët lokale dhe urbane, gjegjësisht caktimin e linjave dhe rendeve të udhëtimit për transportin publik të udhëtareve me autobus për gjatë këtyre traseve.

5.4 Lidhshmëria e transportit në mes vendbanimeve në komunë dhe me komunat fqinjë

Transporti ndër-komunal dhe brenda komunal i udhëtareve–pikat, zhvillimi dhe cilësia.

Transporti nder komunal (nder urban) për gjatë rrugëve Nacionale dhe Regjionale, zhvillohet normalisht nga kompanitë transportuese të cilat pajisen me Licencë dhe rendë të udhëtimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.

Ndërsa, transporti brenda komunal apo lokal zhvillohet kryesisht mbi bazën e Lejes që duhet lëshuar nga komuna (DSHP) prej vendbanimeve të caktuara dhe kryesisht shërben për transportin e nxënësve dhe oraret e linjave janë përcaktuar sipas orarit mësimor të nxënësve të shkollave të mesme (Gjimnazi “Haxhi Zeka” në Istog, dhe Shkolla e Mesme Teknike “Mithat Frashëri” – Gurrakoc).

Rendi i udhëtimit kompanive qe kryejnë transportin lokal, e që është nen përgjegjësin dhe menaxhimin e komunës, ju lëshohet për periudhën 1 vjeçare, bazuar ne rregulloren komunale: “Për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba”, ku pas kalimit të afatit ju vazhdohet për te njëjtën periudhë, ku kompania përgjegjëse është e obliguar të parashtrojë kërkesë zyrtare DSHP me dokumentacion të kompletuar për vazhdimin e linjës-rendit të udhëtimit.

6 RENDET E UDHËTIMIT

6.1 Rendet e udhëtimit të linjave nder urbane

Linjat nder urbane në masë të madhe mbulojnë hapësirën territoriale të lokaliteteve të komunës së Istogut për transportin e udhëtareve me autobus, duke përfshirë edhe transportin e nxënësve të shkollave te mesme (vajtje-ardhje).

Ne tabelorin e me poshtëm po japim linjat – nisjet e transportit nder urban që fillojnë nga Istogu, linja të përcaktuara dhe lëshuara e menaxhuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, që njëkohësisht të njëjtat linja kanë edhe kthimin anasjelltas nga komuna ku përfundon linja.

RELACIONI: ISTOG – KLINË – PRISHTINË (14 NISJE); (për gjatë këtij relacioni mbulohen këto lokalitetet të territorit të komunës që mund ta shfrytëzojnë autobusin si mjet për transport: Istog, Istog i Poshtem, Dragolefc, Tomoc, Gurrakoc, Zallq dhe Drejë).

Kohet e nisjes	5^{00}	6^{00}	6^{30}	7^{00}	7^{30}	8^{10}	09^{00}	10^{00}	11^{00}	12^{30}	14^{00}	15^{30}	16^{00}	17^{00}

RELACIONI: ISTOG – VRELLË – BANJË - PEJË (29 NISJE); (për gjatë këtij relacioni mbulohen këto lokalitetet te territorit të komunës që mund ta shfrytëzojnë autobusin si mjet për transport: Istog, Cerrcë, Lubozhdë, Vrellë, Stupe, Kamenica, Lubovë, Banjë dhe Baicë).

Kohet e nisjes	6^{00}	6^{30}	7^{00}	7^{30}	8^{00}	8^{30}	9^{00}	9^{15}	9^{30}	9^{45}	10^{00}	10^{30}	11^{00}

Kohet e nisjes	11^{30}	11^{45}	12^{00}	12^{30}	13^{00}	14^{00}	14^{30}	15^{00}	15^{15}	15^{30}	15^{45}	16^{00}	16^{30}

Kohet e nisjes	17^{00}	17^{30}	18^{00}

RELACIONI: ISTOG – GURRAKOC – PEJË (29 NISJE); (për gjatë këtij relacioni mbulohen këto lokalitetet te territorit të komunës që mund ta shfrytëzojnë autobusin si mjet për transport: Istog, Istog i Poshtem, Dragolefc, Tomoc, Gurrakoc, Prekallë, Dobrushë, Carallukë, Banjë dhe Baicë).

Kohet e nisjes	6^{00}	6^{30}	7^{00}	7^{30}	8^{00}	9^{00}	9^{15}	9^{30}	9^{45}	10^{00}	10^{30}	11^{00}	11^{30}

Kohet e nisjes	11^{45}	12^{00}	12^{30}	13^{00}	13^{30}	14^{00}	14^{30}	15^{00}	15^{15}	15^{30}	15^{45}	16^{00}	16^{30}

Kohet e nisjes	17^{00}	17^{30}	18^{00}

RELACIONI: ISTOG – VRELLË – KALIQAN - PEJË (9 NISJE); (për gjatë këtij relacioni mbulohen këto lokalitetet te territorit të komunës që mund ta shfrytëzojnë autobusin si mjet për transport: Istog, Cerrcë, Lubozhdë, Vrellë, Studenicë, Orroberdë dhe Kaliqan).

Kohet e nisjes	7^{15}	8^{15}	9^{15}	11^{15}	12^{45}	13^{45}	15^{30}	18^{15}	19^{00}

